



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 345/1 Prot.

Elbasan, më 13 . 3 .2024

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit tuaj nr.26 datë 28.02.2024, “Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga fatkeqësi natyrore, (djegia e banesës nga zjarri) të Z. Naim Bajram Brasha, banor në lagjen “Detashmenti” bashkia Librazhd, dhe dhënien e kompensimit financiar nga ana e bashkisë Librazhd (në shumën 214280,5 lekë)”, pasi verifikuam dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të parashikuar në V.K.M nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.04.03.2024

Nr. 1188/13 prot

Nr.26 dt.28.02.2024

**PER MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E
NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME NË BANESAT E
TYRE NGA FATKEQËSI NATYRORE**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 dt.17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore ."ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".si dhe VKM-së nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare,për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore "Kreu III/3/e.Pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ."Për dhënie të ndihmës financiare,per dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (rënie zjarri në banesë) për banesën e Z.Naim BRASHA banorë i lagjes "Dedashmenti".Bashkia Librazhd,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 28.02.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkise Librazhd.

VENDOSI:

- 1.Të miratojë kërkesën e Bashkisë Librazhd ,për mbështetje financiare për shtetasin Naim Brasha banorë i lagjes "Dedashmenti".Bashkia Librazhd për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore(renie zjarri në banesë date 11.02.2024 ora 10:40.)
- 2.Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga specialistët e Bashkisë Librazhd,dhe vlerën e përfitimit financiar në shumën 214 280.5 lekë,për dëmin e shkaktuar nga fatkeqësi natyrore(dëmtim banese,orenditë,mobiljet dhe paisjet elektro shtepiake.
- 3.Ti akordojë familjes së shtetasit Naim Brasha ndihmën emergjente në vlerën financiare prej 214 280.5 lekë nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të Shtetit ,për Mbrojtjen Civile akorduar Bashkisë Librazhd për vitin 2024.
- 4.Ndihma financiare për familjen e z.Naim Brasha,dëmtuar nga fatkeqësi natyrore përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr 329 datë 16.05.2012.(50% e vlerës së demit në preventive .shuma 1+2,+vlerën e demit në paisje e orendi sipas pasqyrës)pra $(129780.5+84500=214\ 280.5)$ leke.
- 5.Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së z.Naim Brasha për shkak të fatkeqësisë natyrore(rënie zjarri në banesë).
- 6.Ky vendim hynë ne fuqi 10 (dhjetë)ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU

